



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Planor - Programi Më Dërgo <b>01-02-2016</b>			
Nr. i Dokumentit	Numri i Dokumentit	Titulli	Skema
Org. blyes	Numri i Dokumentit	Titulli	Skema
<b>01-013/107</b>			

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Gazeta zyrtare nr 28/2008, nenit 5.1.1 të Ligjit për mbrojtje nga zjarri nr. 04/L-012 dhe nenit 36 paragrafi 2 pika d) të Statutit të Komunës së Vitisë nr 013/491 të datës 21.04.2011, neneit 9.1.7 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2012MPB-03/2009 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më 29.01.2016 miraton këtë:

**V E N D I M**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS PËR KËSHILLIN KOMUNAL**  
**PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2016 PËR KOMUNËN E VITISË**

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë, APROVON Planin e punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2016 për Komunën e Vitisë.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Plani i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2016 për Komunën e Vitisë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi dhe planit të punës së KKS-së do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Vitisë.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit
2. Shërbimit të Kuvendit
3. Drejtorisë për Shërbime publike,
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
KRYESUESI

Naim Pira

